

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 05.05.2017]

Për: Operatorin Ekonomik “Curri” shpk

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Ndertim i unazës së qytetit bashkia Vau Dejës”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertim i unazës së qytetit bashkia Vau Dejës”**.

Kohëzgjatja: brënda 10 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **200.000.142 (dyqind milion e njeqind e dyzet e dy) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar per vitin 2017 eshte 100.984.506 leke pa tvsh. Pjesa e mbetur eshte parashikuar per vitin 2018.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 27.02.2017.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	CAUSHI	116,376,188
2	NIKA	123,659,226
3	COMPANY RIVIERA 2008	136,570,622
4	CURRI	149,133,123
5	EUROTEOREMA PEQIN	150,000,000
6	ALBAVIA	152,127,671
7	AGRI CONSTRUCTION	154,350,026
8	BE - IS SH.P.K	157,288,576
9	S.M.O.UNION	157,342,573
10	ALBA KONSTRUKSION	157,935,029
11	B-93	172,540,771
12	SHPRESA - AL	175,858,675
13	S I R E T A 2F	177,777,777
14	VARAKU E	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "Caushi" shpk (80%), dhe "Boshnjaku B" shpk (20%) per arsye se:

Shoqeria "Caushi" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Kukes, Memaliaj, Peqin, Berat Gllave, Vrrine dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Ne deklarim nuk jepet data e fillimit te punimeve.

Shoqeria "Boshnjaku B" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Gjirokaster, Lushnje, Mallakaster dhe Durres dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria "Boshnjaku B" shpk nuk ploteson piken 2.2.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi ne dokumentin perkates, administratori i shoqerise "Boshnjaku B" shpk, ka deklaruar se: "Shoqeria "Caushi" shpk ka paguar taksat...". Nderkohe, nuk eshte paraqitur deklarate per shoqerine "Boshnjaku B" shpk.

Shoqeria "Boshnjaku B" shpk nuk ploteson piken 2.3.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me mjetet dhe paisjet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje impianti automatik betoni. Nderkohe kjo shoqeri ka marre persiper punimet per ndertimin e tombinove, per te cilat ky impiant eshte i domosdoshem.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

2. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Nika” shpk (11,3%), “Erniku” shpk (78,6%) dhe “Rroku Guest” shpk (10,1%) per arsye se:

Shoqeria “Erniku” shpk nuk ploteson piken e Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve per energjine elektrike, pasi ka detyrime ne shumen 45.153,12 leke per kontraten me kod BUOE350082099012.

Shoqeria “Erniku” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punimet e ngjashme pasi puna e paraqitur “Rikonstruksion rruga Aeroport Bicaj Qafa e Kolosjanit Domje” eshte realizuar ne vitet 2011 – 2013 dhe eshte jashte afatit tre vjecar te kerkuar.

Shoqeria “Erniku” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me mjekun e ndermarrjes pasi nuk ka paraqitur dokumentacion.

Shoqeria “Rroku Guest” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punimet e ngjashme pasi per punen e deklaruar “Sistemim asfaltim i rruges Qender Grude e re – Qender Golem” nuk ka paraqitur faturat tatimore ne perputhje me kerkesen per kualifikim.

Shoqeria “Rroku Guest” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me mjekun e ndermarrjes pasi nuk ka paraqitur dokumentacion.

3. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Company Riviera 2008” shpk (57,6%), dhe “Ndrekaj” shpk (42,4%) per arsye se:

Vlera totale e punimeve qe duhet te kryeje shoqeria “Company Riviera 2008” shpk nese shpallet fituese e kontrates qe shqyrtohet eshte 115.200.081 leke, nderkohe qe kjo shoqeri zoteron piken e licenses NP-4C e cila i lejon te kryeje ne te njejten kohe punime me vlere te pergjithshme jo me shume se 100.000.000 leke. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIB kjo shoqeri duhet te skualifikohet.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

4. Te skualifikoje shoqerine “Euroteorema Peqin” shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Milot – Lezhe - Rreshen nga viti 2011 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profilin transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit. Inxhinerja e deklaruar eshte inxhiniere ndertimi.

5. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Albavia” shpk (74%), dhe “Karl Gega Konstruksion” shpk (26%) per arsye se:

Shoqeria “Albavia” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit. Ka paraqitur dokumentacion per nje specialist qe ka mbaruar studimet per kimi industriale dhe si i tille nuk mund te zoteroje kualifikimet e inxhinierit te mjedisit. Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion se ka kualifikime specifike ne fushen e mjedisit.

Shoqeria “Karl Gega Konstruksion” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit. Ka paraqitur dokumentacion per nje specialist qe ka mbaruar studimet per

kimi industriale dhe si i tille nuk mund te zoteroje kualifikimet e inxhinierit te mjedisit. Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion se ka kualifikime specifike ne fushen e mjedisit.

Shoqeria "Karl Gega Konstruksion" shpk nuk ploteson piken 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per kete qellim.

Shtojca 9 "Deklarate per disponimin e makinerive" nuk eshte plotesuar vecmas per secilen shoqeri. Nga dokumentacioni i paraqitur per mjetet rezulton se shoqeria "Karl Gega Konstruksion" shpk nuk disponon asnje kamion per kryerjen e puneve qe ka marre persiper.

6. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "Be - Is" shpk (51,5%), dhe "2T" shpk (48,5%) per arsye se:

Shoqeria "Be-Is" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Durres, Librazhd dhe Vlore nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Shoqeria "2T" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne ne Qukes ku qysh prej 07.03.2016 po punon ne objektin "Ndertimi i rruges Qukes Qafe Plloce".

Shoqeria "2T" shpk nuk ploteson piken 2.3.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punesimin e mjekut, pasi kontrata me mjekun eshte lidhur ne daten 05.01.2017 dhe jo nga Nentori 2016 e ne vazhdim sic kerkohet ne kerkesen per kualifikim.

7. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "SMO Union" shpk (51%), dhe "Liqeni VII" shpk (49%) per arsye se:

Shoqeria "Liqeni VII" shpk nuk ploteson piken 2.2.3 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi ka gjithesej 11.654 euro afersisht 1.631.560 leke, nderkohe qe, bazuar ne perqindjen e punes qe ka marre persiper, duhet te kishte 9.800.006 leke.

Shoqeria "Liqeni VII" shpk nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e disa objekteve por vlere e objektit me te madh te deklaruar eshte 64.339.397 leke pa tvsh, nderkohe qe duhet te kishte realizuar me nje pune te vetme nje objekt me vlere jo me pak se 49.000.034 leke pa tvsh. Gjithashtu nuk ploteson kushtin as me vleren e plote te gjithe puneve te deklaruar, pasi vlere eshte 188.301.455 leke pa tvsh, nderkohe qe sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper duhet te kishte realizuar jo me pak se 196.000.139 leke punime pa tvsh.

8. Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "Shpresa AI" shpk (49,08%), dhe "AI Asphalt" shpk (50,92%) per arsye se:

Shoqeria "Shpresa AI" shpk nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e disa objekteve si rruge, godina, prita malore, punime mirembajtje, ura, HEC etj. Si objekte te ngjashem nga ana e komisionit u konsideruan vetem rruget dhe si perfundim vlere e plote e objekteve te realizuar nga kjo shoqeri, pa tvsh, ne tre vitet e fundit, eshte 61.448.983 leke, ndersa vler pa tvsh e objektit me te madh te realizuar eshte 25.996.575 leke. Me keto vlere nuk ploteson kriterin per kualifikim pasi duhet te kishte realizuar me nje objekt te vetem 49.080.034 leke punime ose me shume objekte 196.320.139 leke punime.

9. Te skualifikoje shoqerine “Varaku E” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Curri” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **149.133.123 (njeqind e dyzet e nente million e njeqind e tridhjetë e tre mije e njeqind e njezet e tre)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.04.2017**.

Ne daten 15.04.2017 paraqiti ankim shoqeria “Nika” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 21.04.2017 duke e refuzuar ate.

Ankesa te tjera nuk ka patur.

